



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec  
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec

REGJISTRUAR NE SHTET

Njësia Nr./Br./No 01/Kuvendi i Komunës

Nr./Br./No 01/22 Nr. i fac/Br. stuf/No pg 399

Dato/Datum/Date 16.12.2022

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenit 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12, nenit 15 dhe nenit 20 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), dispozitave të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Propozimit të Kryetarit të Komunës Nr. 02/3096/22 i datës 08.12.2022, Kuvendi i Komunës në Rahovec, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me dt. 16.12.2022 miraton këtë:

## V E N D I M

### Për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit 2023-2031"

#### Neni 1

Me këtë vendim shpallet në shqyrtim publik projekt-dokumentit "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit 2023-2031".

#### Neni 2

Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i projekt-dokumentit "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit 2023-2031" bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës 8 (tetë) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

- 2.1.Ekspozimi i projekt-dokumentit "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit 2023-2031" bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës.
- 2.2.Për të promovuar gjithë përfshirjen dhe transparencën mbahen prezantimet shtesë sipas planit të organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik.
- 2.3.Për të gjitha prezantimet publike mbahet procesverbali.
- 2.4.Shqyrtimi publik i projekt-dokumentit "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit 2023-2031" zgjatë 30 (tridhjetë) ditë sipas procedurave të planifikuara me ligj.
- 2.5.Shpallja e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit 2023-2031" bëhet 8 (tetë) ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, faqen zyrtare të komunës dhe mediat televizive publike dhe lokale.

#### Neni 3

- 3.1.Në shqyrtim publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e projekt-dokumentit "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit 2023-2031".
- 3.2.Në shqyrtim publik prezantohen fazat e projekt-dokumentit "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit 2023-2031", si:

- Informata mbi Kornizën Strategjike,
- Profili i Komunës;
- Vlerësimi i Gjendjes;
- Komiza e Zhvillimit Hapësinor;
- Pjesa Hartografike.

3.3. Projekt-dokumenti "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit 2023-2031" është i qasshëm për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.

#### Neni 4

4.1. Projekt-dokumenti "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit 2023-2031" i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.

4.2. Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku me gojë gjatë diskutimeve, me shkrim në librin e vërejtjeve apë përmes postës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

#### Neni 5

Shqyrtimi i projekt-dokumentit "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit 2023-2031" organizohet nga Komuna e Rahovecit në suaza të kompetencave të përcaktuara me ligj.

#### Neni 6

6.1. Me këtë vendim parashihen sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së shqyrtimit publik të projekt-dokumentit "Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit 2023-2031".

6.2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik.

#### Neni 7

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Rahovecit.

#### Neni 8

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

#### Vendimi u dërgohet:

- Shërbimit të Kuvendit,
- Kryetarit të Komunës,
- Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVECIT

01-Nr.399/22  
Me datë: 16.12.2022

